



Shfaqja Forum Teatër “HISJA”

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) në bashkëpunim me Qendrën për Art dhe Komunitet Artpolis, përkrahur nga PPSE Swisscontact, ka filluar fushatën në kuadër të projektit “Prona e paluajtshme dhe barazia gjinore” përmes prezantimit të shfaqjeve në formë të forum teatrit. Kjo fushatë ka për qëllim të ngrisë vetëdijen tek qytetarët për regjistrimin e pronës së përbashkët dhe ndarjen e trashëgimisë mbi baza të barabarta gjinore.

Fushata ka filluar në Prizren me 11 Korrik dhe do të vazhdojë në këto komuna:

GJAKOVË me 13 Korrik, nga ora 18:00-19:15 tek Pallati i Kulturës “Asim Vokshi”.

PRISHTINË: me 15 Korrik, nga ora 18:00-19:15 në shkollën fillore “Shkëndija, fshati Hajvali.

MITROVICË: me 17 Korrik, nga ora 18:00-19:15 në sheshin “Mehë Uka” përballë bibliotekës së qytetit.

PEJË: me 18 Korrik, nga ora 18:00-19:15 në Teatrin “Istref Begolli” në Pejë.